



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2020:032258

Datë: 12.01.2021

Numri i dokumentit: 01401644

C.nr.1004/2020

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, Divizioni Civil, gjyqtarja Mevlide Kosumi Qarri, me bashkëpunëtorin profesional Besnik Berisha, në çështjen juridike kontestuese të paditësve S. M., H.K., D. A. dhe G. H. që të gjithë nga P., përfaqësuar nga A. M. avokate në P., kundër të paditurës Komuna e Prishtinës-Drejtoria për Arsim, përfaqësuar nga L. B., sipas autorizimit nga “Avokatura I.” sh.p.k me seli në P. rruga “...” Hr... kati . nr..., për shkak të kompensimit të pagave për shpërblim jubilar dhe shujtave ditore, në seancën e dt.24.12.2020, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET në tërësi e bazuar kërkesëpadia e paditësve: S. M., H.K., D. A. dhe G. H që të gjithë nga P., DETYROHET e paditura Komuna e Prishtinës-Drejtoria për Arsim që paditëses S.M., në emër të shpërblimit jubilar për 35 vite të përvojës së punës në vlerë të një page bazë, t’ia paguaj shumën prej 489,15€ si dhe në emër të kompensimit për ushqim gjatë ditëve të punës (shujtave ditore) për periudhën nga dt.18.04.2017 deri me 24.12.2020, nga dy euro për secilën ditë të prezencës në punë në shumë prej 1.776,00€ neto, gjithsej shumën e përgjithshme prej 2.265,15 €; paditëses H. K. në emër të shpërblimit jubilar për 37 vite të përvojës së punës në vlerë të një page bazë, t’ia paguaj shumën prej 494,52 € si dhe në emër të kompensimit për ushqim gjatë ditëve të punës (shujtave ditore) për periudhën nga dt.18.04.2017 deri me 24.12.2020, nga dy euro për secilën ditë të prezencës në punë, në shumë prej 1.776,00 € neto gjithsej shumën e përgjithshme prej 2.270,52€; paditëses D. A., në emër të shpërblimit jubilar për 37 vite të përvojës së punës në vlerë të një page bazë, t’ia paguaj shumën prej 531,95 € si dhe në emër të kompensimit për ushqim gjatë ditëve të punës (shujtave ditore) për periudhën nga dt.18.04.2017 deri me 24.12.2020, nga dy euro për secilën ditë të prezencës në punë, në shumë prej 1.776,00€ gjithsej shumën e përgjithshme prej 2.307,95€; paditëses G. H., në emër të shpërblimit jubilar për 18 vite të përvojës së punës në vlerë të 50% të një page bazë, t’ia paguaj shumën prej 205,39 € si dhe në emër të kompensimit për ushqim gjatë ditëve të punës (shujtave ditore) për periudhën nga dt.18.04.2017 deri me 24.12.2020, nga dy euro për secilën ditë të prezencës në punë, në shumë prej 1.776,00 € gjithsej shumën e përgjithshme prej 1.981,39€, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8%, nga data 24.12.2020, në

afat prej 7 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit ligjor.

II.DETYROHET e paditura Komuna e Prishtinës – Drejtoria Komunale e Arsimit në Prishtinë, që paditëseve t'ua paguaj shpenzimet e procedurës në shumën prej 996,00 €.

A r s y e t i m

Paditësit në këtë Gjykatë, përmes të autorizuarës së tyre me dt.02.03.2020 kanë paraqitur padi kundër të paditurës për kompensimin e pagave jubilarë dhe kompensimin e shujtave. Paditësit përmes të autorizuarës së tyre në padinë e ushtruar, precizimin e padisë si dhe në shqyrtimin e kryesor kanë deklaruar se janë të punësuar te e paditura si mësimdhënës në SHFMU “N.” në P.. Tutje, ka theksuar se duke marr parasysh kohën e nënshkrimit të kontratës kolektive të arsimit të Kosovës të datës 18.04.2017 dhe të drejtave të cilat u njihen me këtë kontratë punëtorëve të arsimit, ku ndër të tjera neni 35 par.7 ka paraparë të drejtën e kompensimit për ushqim gjatë punës, të cilën të drejtë paditësit nuk e kanë realizuar deri më tani. Gjithashtu, ka deklaruar se në bazë të kësaj kontrate, neni 35 par.8, punëtorëve të arsimit ju takon edhe shpërblimi jubilar i cili duhet të paguhet me rastin e 7 marsit të çdo viti. Në bazë të kësaj i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësve ta aprovoj si të bazuar duke e detyruar të paditurën që paditësve, në emër të shpërblimit jubilar për vitet e përvojës së punës dhe në emër të kompensimit për ushqim gjatë ditëve të punës (shujtave ditore), ti kompensoj paditësit si në precizimin e dt.23.12.2020.Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E autorizuar e të paditurit, si në përgjigje në padi edhe në shqyrtimin kryesor e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësës. Tutje, ka shtuar se e paditura nuk ka obligim ndaj paditësit pasi që Komuna e Prishtinës nuk është nënshkruese e kontratës kolektive, por të njëjtën e ka nënshkruar Ministria e Arsimit ku neni 46 par.1 është paraparë se MASHT dhe SBASHK, do të angazhohen për të informuar dhe ndihmuar komunën që të bëjnë planifikimin me kohe të buxhetit, mirëpo kjo nuk ka ndodhur, andaj Komuna e Prishtinës në skemën e saj buxhetore nuk ka paraparë këtë lloj kompensimi. Mbi bazën e këtyre pretendimeve i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditës ta refuzoj në tërësi si të pa bazuar. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Për të vlerësuar drejtë dhe për të vërtetuar saktë gjendjen faktike, duke vepruar sipas propozimit të palëve, gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor administroi provat dhe atë: Vërtetimin nr.1148/20 të dt.23.01.2020, Vërtetimin nr.2143 të dt.21.12.2020, Kontratën e punës nr.219 të dt.02.09.2019, Qarkullimin bankar për G. H., Vërtetimin nr.1086 të dt.23.01.2020, Vërtetimin me nr.2140/20 të dt.23.01.2020, Qarkullimin bankar për D. A., Kontratën e punës nr.01 nr.031-120876/1 e dt.09.06.2015, Vërtetimin nr.1123/20 të dt.23.01.2020, Kontratën e punës nr.130/99 të dt.01.09.1999, Vërtetimin nr.2142 të dt.21.12.2020, Qarkullimin bankar për H. K., Vërtetimin nr.1136/20 të dt.23.01.2020,

Kontratën e punës nr.110/04 të dt.01.11.2004, Vërtetimin nr.2141/20 të dt.21.12.2020 dhe Qarkullimin bankar për S. M..

Pasi që Gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së) arriti në përfundimin se në këtë çështje juridike kontestimore duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga provat e administruara si më lartë, gjykata vlerësoi se kërkesëpadia e paditësve është e bazuar.

Nga kontratat e punës të lidhura mes paditësve dhe të së paditurës si dhe nga Vërtetimet e lëshuara nga Shkolla Filllore e Mesme e Ulët “N.” në P. u vërtetua fakti se paditësit janë duke punuar tek e paditura si mësimdhënës-e. Nga kjo vërtetohet se në mes palëve ndërgjyqëse ekziston raporti civil-juridik dhe në mes tyre janë krijuar të drejta dhe detyrime të cilat janë parashtruar përmes padisë.

Siç rezulton nga pretendimi i palëve ndërgjyqëse dhe shkresat e lëndës paditësve nuk i është paguar shpërblimi në emër të pagës jubilarë e as kompensimi për shujtat ditore për ditët e vijimit në punë, ashtu siç përcaktohet me nenin 35 par.8 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017, ku është paraparë pagesa jubilarë.

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata vlerëson, se e paditura ka pasur detyrim që paditësve t’ia paguaj pagën jubilarë përkritazi me përvojën e tyre të punës, ngase me provat e deponuara siç janë vërtetimet mbi përvojën dhe prezencën në punë të lëshuara nga SHFMU “N.”, është vërtetuar se paditësit kanë arritur përvojën e nevojshme për ti takuar pagesa në emër të pagës jubilarë, si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Gjithashtu gjykata vlerësoi si të drejtë dhe të mbështetur në prova kërkesën e paditësve sa i përket kompensimit për ushqim gjatë ditëve të punës ku përmes vërtetimevetë lartcekura rezulton prezenca në punë nga data 18.04.2017 deri me datë 24.12.2020, duke llogaritur nga 2 euro për secilën ditë. Lidhur me këtë, kërkesa gjen mbështetje në nenin 35 par.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017, ku është paraparë pagesa e ushqimit për punëtorët, për ditët të cilat janë në punë, në lartësi prej 2 €, me përjashtim në rast se e paditura e ka të rregulluar këtë çështje përmes restaurantit apo kuzhinës ose në një formë tjetër. Gjykata bazuar në dispozitat e lartcekura si dhe nga shkresat e lëndës nuk ka ndonjë provë me të cilën do të vërtetohej se e paditura e ka rregulluar në ndonjë formë tjetër këtë çështje, andaj vendosi që paditësës t’i kompensohet kjo e drejtë.

Gjykata me rastin e vendosjes vlerësoi edhe kundërshtimet e të autorizuarës së të paditurës se nuk ka fonde për pagesën e pagave, mirëpo të njëjtat nuk i mori për bazë, nga se në rastin konkret kanë qenë në fuqi dispozitat e cekura më lartë të Kontratës Kolektive, në bazë të të cilave paditësit i takon e drejta në shpërblimin jubilar si dhe ushqimin ditor.

Nga elaborimi i provave të lartcekura u vërtetua se e paditura duke mos e kryer detyrimin e saj, iu ka mbetur borxh paditësve për pagesën pagave jubilarë për vitet e përvojës së punës dhe shujtave për ushqim, andaj ndërmjet palëve ndërgjyqëse është krijuar raporti detyrimor, në të cilin paditësit e kanë cilësinë e kreditorit, ndërsa e paditura cilësinë e debitorit, bazuar nën nenin 245 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD-së) parashihet se *“kreditori në marrëdhëniet detyrimore ka të drejtë që nga debitori të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë përmbushjen e detyrimit në tërësi në përputhje me përmbajtjen e tij”*, prandaj, gjykata duke u nisur nga fakti se e paditura iu ka mbetur borxh paditësve, me aplikimin e dispozitës së lartcekur dhe në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, vendosi që ta detyroj të paditurën që paditëses t’ia kompensoj borxhin në shumat e gjykuara.

Lartësia e kamatës së përcaktuar prej 8 % i referohet nenit 382 par.1 dhe 2 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, dhe si moment të fillimit të kamatës gjykata ka marr datën e marrjes së aktgjykimit gjegjësisht prej datës 24.12.2020, sepse e paditura nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi ka rënë në dijeni lidhur me detyrimet financiare që i ka ndaj paditësit.

Vendimin që pala e paditur t’i bartë shpenzimet e procedurës, Gjykata e ka mbështetur në dispozitën nga neni 449, 452 të LPK-së dhe i referohet shpenzimeve për padi 260.00 €, për dy seanca 676,00 € dhe për taksë gjyqësore shumën prej 60 €, gjithsej shumën prej 996.00 €.

Nga të lartcekurat u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e konform nenit 143 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.1004/2020, dt.24.12.2020

G j y q t a r j a
Mevlide Kosumi Qarri

UDHËZIM JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj gjykate.